

DON KISHOTI I MANÇËS - Miguel de Cervântes Saavedra

-Don Kishoti simbolizon gjithçka të mirë, që bota ka nevojë: drejtësinë, lirinë, shpirtmirësinë, altruizmin, fisnikërinë. Kredoja e tij është bukuria.

-Don Kishot, donkishotizëm, donkishotesk kanë në thelb dëshirën naive, shpesh të parealizueshme të triumfit të së mirës, drejtësisë, dinjitetit fisnik dhe shoqërisë, ëndrra të brishta në një realitet të vrazhdë, të shëmtuar, vrastar.

-Rrëfimi është ironik dhe alegorik me personazhe, që nuk përkojnë me realitetin e përditshëm.

-Thelbi i figurës së Don Kishotit: është humanist, mendimi fisnik, frymëzimi poetik, ideali i lartë, një hero për ne edhe simpatik, që braktis rehatinë dhe komoditetin shtëpiak për të dalë përballë rreziqeve, është i gatshëm tu japi njerëzve në nevojë lirinë e munguar.

-Sanço Pança duket si shtojca e ustait, ka iluzione, por në drejtim të kundërt me të, shpirt praktik, simbolizon mentalitetin e ngushtë fshatar, shkon pas tij për interesa personale.

-Në fund të dy ndryshojnë. Don Kishoti i jep fund iluzioneve të kota dhe Sançoja heq dorë nga synimet e tij e i qëndron besnik deri në fund zotërisë të tij, shenjë kjo e idealizmit.

Don Kishoti:

- i gjatë, i dobët, thatanik
- qëllimi i tij është të mbrojë të pafajshmit, të dobët e të vendosi drejtësinë
- me mendje të turbullt
- sojli, njeri i lexuar
- “kalorës i arratisur”
- altruist
- kërkon të kthejë pas historinë
- ideale të pamundura
- aventurier, i palodhur
- guximtar
- mendon thellë

Sanço Pança:

- i shkurtër, i shëndoshë, topolak
- qëllimi i tij është që të pasurohet duke punuar për Don Kishotin
- i shikon gjërat ashtu si janë
- katundar i thjeshtë, i paditur
- shqytar
- interesaxhi
- do që të eci përpara

- realitet i vrazhdë
- mendjengushtë, vulgar
- frikacak
- mendon cekët

Të përbashkëtat:

- të dy vijnë nga Mança dhe janë burra në moshë të mesme
- ndjekin të njëjtën rrugë
- nevoja dhe plotësimi i njëri-tjetrit
- ëndërrojnë me sy hapur
- anakronik dhe qesharakë
- besnikë

Mesazhet universale të Don Kishotit lidhen me njeriun dhe iluzionet, të shkuarën dhe të ardhmen.

1. Sa më shumë të fluturojnë iluzionet, aq më shumë rrëzohemi.
2. Nuk mund ta ndërtojmë të ardhmen, duke përdorur mjetet e së shkuarës.
3. Është e rëndësishme të jemi në kohën dhe vendin e duhur e të përdorim mjetet e duhura.
4. Analizimi me sy kritik na jep një kuptim më të qartë, sesa marrja e gjërave të mirëqena, ashtu si janë.